

# diktator, duhet larguar

**Schwartz për Naim Tërnavën:** “Kush është ky njeri? Enver Hoxhë Tërnavë? Ahmet Zogu Tërnavë? E di që kundërshtarët e quajnë “Sulltan Tërnavë”. Unë e mendoj atë si “Stalin Tërnavë”. Ai duhet të hiqet nga çdo përgjegjësi në BIK dhe të gjejë diçka të dobishme për të bërë. Ai duhet të ndjekë shembullin e ish-presidentit amerikan, Jimmy Carter, dhe të bëhet vullnetar në riparimin dhe ndërtimin e shkollave publike dhe shtëpive të reja...”



**KD:** Së voni, një parti islamike është formuar në Kosovë, e cila gjerësisht shihet si hyrje e ekstremizmit islamik edhe në peizazhin politik të Kosovës. Çka mendoni për këtë? Mendoni se ka rrezik të vërtetë nëse një parti politike mban këndvështrime ekstreme religjioze?

**Schwartz:** LISBA zor që është parti dhe e meriton të injorohet. Kosova e ka marrë rrugën e shekullarizmit. Kush do ta përkrahë një shtet islamik në këtë republikë? Njerëzit në LISBA, sikur Tërnavë, duhet të tërhiqen nga intrigat dhe aventurat e tyre dhe të gjejnë ndonjë profesion të dobishëm. Në rastin e tyre, të ndërtojnë shkolla dhe shtëpi me gjasë do të ishte tepër sfiduese. Ata mund t'i pastrojnë rrugët, meqë e bënë veten të duken të marrë duke i nxitur myslimanët të luten në rrugë. Nuk i marr seriozisht. Por, natyrisht, asnjë parti politike nuk duhet të mbajë qëndrime ekstreme religjioze.

**KD:** Çka mendoni për islamin në politikë në përgjithësi?

**Schwartz:** Jam kundër përzierjes së religjionit dhe politikës – por të gjitha religjionet kanë qenë të përfshira në politikë, dhe sikur që e thashë më herët, përpjekja jonë për të mbrojtur islamin e moderuar nuk është jopolitike. Është një çështje e komplikuar që është mbuluar nga retorika e tepruar. Nëse islami politik nënkupton, sikur që është rasti te sunitët Barelvi në Pakistan, kundërshtim të terrorit fundamentalist atje, unë e përkrah islamin politik Barelvi. Nëse islami politik nënkupton, sikur që ishte rasti me Shi-a't iraniane më 2009, demonstrime të lëvizjes së gjerlbër kundër diktaturës së klerit, unë e përkrah islamin politik të lëvizjes së gjelbër. Aty ku islami politik nënkupton luftë për çlirim të të shtypurve – që e konsideroj rrugën esenciale për të interpretuar librin e Zotit, Quran al-qerim – unë do ta mbroj atë. Ndër heronjtë e mi përfshihen Ismail Qemal Vlora dhe Luigj Gurakuqi, që ishin njerëz të fesë dhe të politikës. Ismail Qemal Vlora ishte një burrështetas otoman, ndërsa Luigj Gurakuqi ishte kristian-demokrat. Theofan Stilian Noli ishte ngjashëm një njeri i religjionit dhe

politikës, sikur që ishte një tjetër model i madh për mua, Faik Bej Konica. Këta ishin po ashtu edhe njerëz të mëdhenj të kulturës, shqiptarë e gazetarë. Por transformimi i teologjisë në ideologji, sikur që është rasti me vahabizmin, “Vël-lazërinë Myslimane”, e të tjerë që i përmenda më herët, krijoi një “islam politik” të përkushtuar ndaj uzurpimit, shtypjes, dhe terrorit. Politika e lirisë islamike duhet të mposhtë politikën e shtypjes, shfrytëzimit dhe manipulimit të myslimanëve.

**KD:** Së shpejti do të mbahen zgjedhjet për kreun e Bashkësisë Islame të Kosovës (BIK). Procesi tashmë ka treguar se ka konflikt serioz brenda vetë BIK-ut, mes grupit të moderuar dhe tjetrit, që shihet si më ekstrem. Cili është këndvështrimi juaj për këto që po ndodhin aty?

**Schwartz:** Mendoj se Tërnavë ka bërë gabimin fatal kur ka kërkuar dhe ka marrë me gjasë të drejtën për mandatin e tretë në krye të BIK-ut. I gjithë populli i Kosovës e di për sulmet fizike që i janë bërë klerit dhe shkollarëve të moderuar, shkarkimit të mësuesve dhe klerikëve, dhe gjithë skemave tjera të Tërnavës. Por, “amendamenti” i Kushtetutës, dhe ngjarjet që e kanë përcjellë atë, ishin, mendoj, goditja përfundimtare ndaj kredibilitetit të tij. Një njeri që nuk çan kokën për dinjitetin e besimit të tij dhe të besimtarëve, i tërheq myslimanët e Kosovës larg rrugës së drejtë. Por, kosovarët po e kthejnë goditjen dhe vija e frontit tani është në zgjedhjet e BIK-ut.

**KD:** Qendra juaj publikisht ka kontestuar kredibilitetin e Naim Tërnavës si Reis ul-Ulema i Republikës së Kosovës. Cilat janë dyshimet e juaja, saktësisht?

**Schwartz:** Naim Tërnavë është një plagjiator që ka përvetësuar doktoratën e shkollarit maqedonas mysliman, dr. Zija Abdullah, ashtu që Tërnavë mund të marrë për vete një magjistraturë të kontestueshme. “Koha Ditore”, një gazetë e kredibilitetit më të lartë në Republikë, ka raportuar për hetimin tonë të kësaj çështjeje. Unë dhe qendra ime, pasi kemi ekzaminuar

rastin me kujdes të jashtëzakonshëm dhe ndjeshmëri për pesë vjet prej se kemi dëgjuar për këtë për herë të parë – duke vepruar me durim dhe ndershëm, në mënyrë islamike – kemi konkluduar se Tërnavë vetëm me plagjiatizmin e tij akademik është i papërshtatshëm për të shërbyer në BIK në çfarëdo cilësie. Mungesa e doktoratës tek ai thjesht e vërteton këtë përgjegjësi për të kryer funksionin e reis ul-ulemas.

**KD:** Pra, ju mendoni se z. Tërnavë nuk ka autoritet moral për t'i udhëhequr myslimanët e Kosovës?

**Schwartz:** Mendoj se Naim Tërnavë nuk ka autoritet moral për të udhëhequr askënd. Ai duhet t'i gjejë vetes një profesion, silur që e thashë. Shkollat kanë nevojë për rindërtim. Çekanët, gozhdët dhe materiali ndërtimor po presin. Nuk do t'ia besoja atij asnjë pozitë administrative apo çfarëdo posti që përfshin përgjegjësi për të holla. Nuk do ta lejoja të punonte as si nëpunës në PTK apo KEK, ku mblidhen pagesat nga publiku.

**KD:** Së fundi, cila mendoni se duhet të jetë rru-ga përpara për komunitetin islam në Kosovë, cilat janë rreziqet më të mëdha dhe çka mund të bëhet për t'i penguar ato?

**Schwartz:** BIK-u duhet ta largojë Tërnavën dhe klikën e tij, ta kthejë në vend Kushtetutën, të rivendosë profesorët e larguar dhe klerin në pozitë e tyre, të studiojë devijimet në 10 vjetët e kaluar, dhe t'i kthehet shembullit të vendosur nga një tjetër njeri që unë e kam nderin ta quaj mik, dr. Rexhep Boja. Ata duhet t'i ndalojnë agjitorët radikalë islamikë nga hyrja në vend. Ata mund ta bëjnë këtë me ndihmën e personaliteteve politike jofetare, shtetit, dhe sufive. I vetmi rrezik për Kosovën është kompromisi me islamin radikal dhe dorëzimi përpara konspiracioneve serbe. Që të dyja do të mposhten, Kosova do të jetë e lirë nga ndërhyja e huaj e çdo lloji, dhe do të bëhet burim i krenarisë për çdo mysliman në botë.

© KOHA Ditore